



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 49/2020 regjistër (JR)  
Datë 16.11.2020

Nr. 4 i vendimit  
Datë 16.02.2023

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Relatore</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 16.02.2023, ditën e enjte, në orën 16:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 49/2020, datë 16.11.2020, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni C, pika 2 e neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në prani të palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi dhe shqyrtoi pretendimet e Komisionerit Publik të paraqitura në ankim dhe në konkluzionet përfundimtare, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi dhe shqyrtoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), dhe të avokatit të saj Julian Mërtiri, të cilët kërkuan përfundimisht lënien në fuqi të vendimit nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo) [në vijim “subjekti i rivlerësimit”], i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga organet ndihmëse, si vijojnë.

2.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsytuar, duke konstatuar se:

- (i) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;*
- (ii) *dokumentacion jo i plotë ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

<sup>1</sup> Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Enkeleda Osmani (Xhengo) është përcjellë në Komision me shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 21.02.2019.

<sup>2</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 27.10.2017, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KZHD-së nr. {\*\*\*}, datë 31.07.2019, përcjellë në Komision me shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 01.08.2019.

2.3 Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), ka përcjellë pranë Komisionit raportin<sup>3</sup> për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit dhe me vendimin nr. 275, datë 20.07.2020, vendosi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet e arritura si më poshtë.

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, *referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.*

3.2 Për kriterin e kontrollit të figurës, *referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

3.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, *referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44, pika a e ligjit nr. 84/2016.*

## III. Shkaqet e ankimit

4. Komisioneri Publik Florian Ballhysa ka paraqitur ankim<sup>4</sup> kundër vendimit nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).

5. Komisioneri Publik, në ankim, ka vlerësuar se vendimi nr. 275, datë 20.07.2020, i Komisionit, është i cenusshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”). Komisioneri Publik ka vlerësuar të paraqesë si shkaqe ankimi, rrethanat ligjore dhe ato të faktit, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me:

<sup>3</sup> Raporti i KLP-së nr. {\*\*\*} prot., datë 12.06.2019.

<sup>4</sup> Ankimi i Komisionerit Publik, publikuar në: <https://ikp.al/2020/10/30/ankim-kunder-vendimit-nr-275-date-20-7-2020-te-kpk-se-per-subjektin-e-rivleresimit-znj-enkeleda-osmani-xhengo/>

(i) ekzistencën e burimeve të krijimit të të ardhurave të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës;

(ii) deklaratimet e pasakta dhe të pamjaftueshme lidhur me posedimin dhe përdorimin e likuiditeteve *cash* ndër vite;

(iii) pamjaftueshmërinë financiare për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasuritë apartament banimi në Tiranë, apartament banimi në {\*\*\*}, Kavajë, dhe një automjet;

(iv) pamjaftueshmërinë financiare për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet për vitet 2012 dhe 2015.

6. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, për konfirmimin në detyrë.

Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 4 e 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji të vendosë:

- o Ndryshimin e vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

##### *A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

###### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisioneri Publik të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### *b) Legjitimimi i ankuesit*

8. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 275, datë 20.07.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) në seancë gjyqësore publike, e zhvilluar në prani të palëve.
10. Në kuadër të veprimeve përgatitore të çështjes, janë ftuar palët pjesëmarrëse në këtë proces, subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, që të depozitojnë në Kolegj parashtrimet e tyre me shkrim, së bashku me aktet që kërkojnë të merren në cilësinë e provës në gjykim, në mënyrë që këto parashtrime dhe aktet t’u komunikohen përkatësisht palëve në proces, për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, për efekt të një ekonomie gjyqësore dhe të menaxhimit sa më efikas të procesit gjyqësor.
11. Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, drejtuar trupit gjykues, për marrjen në cilësinë e provës të akteve shkresore të depozituara së bashku me parashtrimet e tij, trupi gjykues, pasi dëgjoi edhe Komisionerin Publik lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm<sup>5</sup>, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës, aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit<sup>6</sup>.

---

<sup>5</sup> Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 24.01.2023.

<sup>6</sup> Aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit e të administruara nga trupi gjykues në cilësinë e provës, janë:

- shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 24.02.2021, e drejtoreshës së Qendrës Shëndetësore nr. {\*\*\*}, Tiranë, drejtuar znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), me lëndë: “Kthim përgjigje”, bashkëlidhur saj: deklarata me shkrim dore e mjekes së familjes A. E.;

- shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 08.03.2021, e drejtorit të përgjithshëm të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, drejtuar znj. Enkeleda Osmani, me lëndë: “Kthim përgjigje”, bashkëlidhur saj: shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 05.03.2021, e Shërbimit të Statistikës pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, drejtuar Drejtorisë Juridike të QSUT-së;

- kërkesë, datë 19.02.2021, e znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;

- shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 01.03.2021, e kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Tiranë, drejtuar znj. Enkeleda Osmani, me lëndë: “Kthim përgjigje mbi mënyrën e pagesës”;

- kërkesë, datë 23.02.2021, e znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), drejtuar OSHE, Durrës;

- shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 28.02.2022, e drejtorit të Drejtorisë Rajonale Durrës, të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, OSHEE Group, drejtuar znj. Enkeleda Osmani, me lëndë: “Kthim përgjigje”;

- kërkesë, datë 07.12.2021, e znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), drejtuar Ujësjellës Kanalizime ShA, Kavajë;

- shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 13.12.2021, e administratorit të Ujësjellës Kanalizime ShA, Kavajë, drejtuar znj. Enkeleda Osmani, me lëndë: “Kthim përgjigje”;

- kërkesë, datë 02.12.2021, e znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë;

- shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 07.12.2021, e drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, drejtuar znj. Enkeleda Osmani, me lëndë: “Kthim përgjigje”;

- shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 16.12.2021, e drejtorit të Drejtorisë së Arkivit Qendror të ISSh-së, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, me lëndë: “Kthim përgjigje”;

12. Në kuadër të denoncimeve nga publiku të depozituara në Kolegj nga denoncuesit V. Ç., S. T. dhe A. G.<sup>7</sup>, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos i ftojë palët të mbajnë qëndrim për to, pasi nga verifikimi i përmbajtjes së tyre, rezultoi se haptazi nuk paraqisnin fakte apo rrethana që kishin nevojë për hetim të mëtejshëm nga ana e Kolegjit, bazuar në parashikimet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik dhe subjekti i rivlerësimit nuk shprehën interes për t'u njohur me denoncimet, duke u pajtuar me vendimmarrjen e trupit gjykues për to.
13. Në seancën gjyqësore publike të datës 03.02.2023, në konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik, duke u qëndruar shkaqeve të ankimit, parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën gjyqësore të datës 24.01.2023, në vlerësim edhe të provave të administruara në kuadër të këtij gjykimi, kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).  
Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

*B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë*

14. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit për vitet 2006, 2007 dhe 2008, nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasurinë apartament banimi, me

- 
- vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 09.03.2021, i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 05.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
  - vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 07.04.2021, i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
  - vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 07.04.2021, i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 07.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
  - vërtetim i njësisë me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 28.12.2022, i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
  - vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 28.12.2022, i përmbaresit gjyqësor privat "L. D.";
  - vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 11.01.2023, i kryetarit të Zyrës Përmbare Tiranë;
  - deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.09.2021, e znj. V. Z.;
  - kërkesë për informacion, datë 10.01.2023, e znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë;
  - shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 12.01.2023, e drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), me lëndë: "Kthim përgjigje";
  - vërtetim njësie me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 17.01.2023, i kartelave të llogarive për periudhën 01.01.2006 - 31.12.2006, të "{\*\*\*}" ShPK;
  - vërtetim njësie me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 17.01.2023, i kartelave të llogarive për periudhën 01.01.2007 - 31.12.2007, të "{\*\*\*}" ShPK;
  - vërtetim njësie me origjinalin nr. {\*\*\*} rep., datë 17.01.2023, i kartelave të llogarive për periudhën 01.01.2008 - 31.12.2008, të "{\*\*\*}" ShPK;
- <sup>7</sup> Denoncimi i z. V. Ç. është regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.05.2018; denoncimi i z. S. T. është regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.05.2021; denoncimi i z. A. G. është regjistruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} prot., datë 24.01.2023.

sipërfaqe 111,87 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, si dhe shpenzimet dhe investimet e kryera, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.

15. Komisioni, gjatë procesit të rivlerësimit, në kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë apartament banimi, me sipërfaqe 111,87 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, ka arritur në konkluzionin se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri dhe se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare për krijimin e saj.

16. Komisioni ka arsyetuar<sup>8</sup>, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

*Nga hetimi, rezultoi se në burimin e krijimit janë deklaruar të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në katër shoqëri punëdhënëse, përkatësisht: “{\*\*\*}” ShPK, “{\*\*\*}” ShPK, “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}” ShPK, si dhe dy huat e marra prindërve të bashkëshortit dhe motrës së tij. Për sa u përket huave të marra, trupit gjykues nuk i kanë rezultuar problematika lidhur me mundësinë e krijimit të tyre nga huadhënësit dhe në këtë kontekst konkluzioni është i qartë për njërin prej burimeve të kësaj pasurie. Në burimin e krijimit të kësaj pasurie, nuk është vlerësuar të vijohet arsyetimi i provueshmërisë së burimit të ligjshëm të të ardhurave të përfituara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit në shoqërinë “{\*\*\*}” nga viti 2008-2012, pasi është ezauruar kjo çështje që në pasurinë nr. 1, ku këto të ardhura janë përdorur për këtë pasuri dhe për apartamentin e blerë në vitin 2011, në {\*\*\*}. [...]*

*Lidhur me punësimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues [...] bazuar në faktet dhe rrethanat se: (i) bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit kishte punuar pranë këtij punëdhënësi që prej vitit 2002, konfirmuar ky fakt me disa dokumente të shoqërisë ku citohen takime të njëpasnjëshme me aktorë të ndryshëm me qëllim arritjen e objektivitetit të punës së shoqërisë dhe, ku ndër të tjerë, z. K. O. identifikohet si pjesëmarrës në profilin e tij si inxhinier ndërtimi; (ii) duke konsideruar dhe vlerësuar si burim prove me shkresë, depozitimin nga subjekti të disa çeqeve të lëshuara nga punëdhënësi, administrator A. N., të cilat provonin pagesa të ndryshme në kohë të ndryshme në favor të bashkëshortit të subjektit, pavarësisht që referonin vitin 2002 dhe jo kohën për të cilën u hetua për shkak të krijimit të pasurisë, kohë në të cilën nis edhe martesa bashkëshortore (30.12.2005); (iii) nga identifikimi i shumë projekteve të hartuara dhe realizuara nga kjo shoqëri, konfirmohej edhe prezenca e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në detyrën e inxhinierit të ndërtimit; (iv) nga provueshmëria e profilin dhe ushtrimin të detyrës së tij, si inxhinier i licencuar, që do të thotë se kishte përmbushur kushtet dhe kriteret për të pasur një tagër të tillë dhe që për pasojë drejtpërdrejt provohej se kishte ushtruar të paktën profesionin e tij për 5 vjet, sikurse kërkohej ligjërisht për t’u licencuar, trupi gjykues vlerësoi se të gjithë këta komponentë ishin të mjaftueshëm për të trajtuar më tej ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara në raport me detyrimet tatimore të paguara nga punëdhënësi gjatë hetimit administrativ, si dhe për të pranuar kërkesën e subjektit për të pyetur me cilësinë e dëshmitarit shtetasin A. N., si administrator i shoqërisë punëdhënëse në kohën e përfitimit të kësaj pasurie. Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues, duke vlerësuar fillimisht faktet që lidhen me anën subjektive të*

---

<sup>8</sup> Shih paragrafin 4 të vendimit nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit.

*padijenisë së subjektit, për mospagim të plotë të detyrimeve tatimore nga punëdhënësi, të tilla si: (i) punëdhënësi, për mospagim të detyrimeve ndaj punëmarrësit, dënohej për kundërvajtje administrative, veprim i cili po të kishte ndodhur, do t'i bëhej me dije punëmarrësit, çka nënkupton se njëkohësisht edhe do të shërbente si mënyrë njoftimi për të/punëmarrësin, pra si marrje dijani, për mospagim të detyrimeve tatimore nga punëdhënësi; (ii) punëdhënësi nuk ka zgjedhur kalimin e pagës në favor të punëmarrësit, nëpërmjet sistemit bankar, por pagesat janë kryer në "cash", çka tregon se objektivisht ka qenë e pamundur marrja dijani e punëmarrësit për mospagim të plotë të detyrimeve; (iii) punëdhënësi ka pranuar të shlyejë detyrimet megjithëse shoqëria ishte në likuidim e sipër dhe se pagesa e tatimit sipas informacionit të konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku konfirmohej se legjislacioni tatimor e njëh të drejtën e deklarimit me vonesë, duke paguar interesat dhe penalitetet (gjoba); (iv) punëdhënësi dëshmoi përpara trupit gjykues se punëmarrësi kishte marrë pagën neto në shumën 80.000 lekë, sikurse kishte deklaruar edhe subjekti në kohë reale në deklaratat periodike; si dhe (v) legjislacioni ka rregulluar tavanin e pagës minimale për të cilën duhet të paguhen detyrimet tatimore për profilin e punës së inxhinierit të ndërtimit, krijon bindjen se subjekti ka qenë në kushtet e pamundësisë së marrjes dijani të mospërmbushjes së detyrimeve nga punëdhënësi dhe për sa kohë që gjatë hetimit, Komisioni nuk evidentoi ndonjë rrethanë të marrjes dijani, argumentet dhe provat shkojnë në favor të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se mosveprimi në kohë nga punëdhënësi për pagimin e detyrimit tatimor, por edhe mosushtrimi i detyrave nga inspektorët e tatimeve nuk mund të rëndojnë pozitën e bashkëshortit të subjektit dhe as t'i atribuojnë atij ndonjë përgjegjësi për shmangien e pagimit të tatimit mbi të ardhurat. Lidhur me ligjshmërinë e marrëdhënies së punës, trupi gjykues, duke vlerësuar faktet se: (i) subjekti ka deklaruar të ardhurat për bashkëshortin, në kohë reale; (ii) punëdhënësi dëshmoi përpara trupit gjykues se marrëdhënia e punësimit të bashkëshortit të subjektit ka vijuar prej vitit 2002-2008; (iii) pagesat e përfituara prej tij, janë bërë përmes çeqeve, si një nga mënyrat e parashikuara në nenin 118 të Kodit të Punës (referuar legjislacionit në kohën që ka ndodhur veprimi); (iv) janë derdhur kontributet nga punëdhënësi në favor të punëmarrësit, pavarësisht se vetëm për pagën minimale por që shërbejnë si indicie për të treguar se marrëdhënia e punësimit ka funksionuar; (v) legjislacioni i kohës lejonte mënyrën e pagimit të pagës, sipas parashikimeve kontraktore dhe nuk bënte me përgjegjësi punëmarrësin, çmon se subjekti ka shpjeguar bindshëm marrëdhënien e punësimit me këtë shoqëri. [...] Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se subjekti: ka kryer deklarim të saktë dhe ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie; ka burime financiare të ligjshme për krijimin e saj për vitet 2006-2009, pavarësisht balancës negative prej 143.348 lekësh të rezultuar në vitin 2008, vlerë kjo që nëse do të përfshiheshin të ardhurat nga punësimi në shoqëritë për të cilat është ngritur padi gjyqësore, subjekti do të gjendej në balancë pozitive.*

17. Komisioneri Publik, në ankim, ka kundërshtuar arsyetimin dhe konkluzionet e mësipërme të Komisionit, duke argumentuar se në analizë të rrethanave juridike të provuara dhe situatës faktike të konstatuar për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 111,87 m<sup>2</sup>, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë, përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të bazuara në prova, në ligjin e zbatueshëm, si dhe jurisprudencën e Kolegjit. Komisioneri Publik ka pretenduar se për marrëdhënien e punësimit të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë "{\*\*\*}" ShPK, për shkak të së cilës subjekti



i rivlerësimit, në deklaratat periodike të interesave të viteve 2006-2008, ka deklaruar të ardhura vjetore në shumën totale 2.560.000 lekë:

- (i) nuk provohet që ajo të jetë e rregulluar me një kontratë midis palëve;
- (ii) vlera e deklaruar e pagës nuk rezulton të ketë kaluar nëpërmjet sistemit bankar;
- (iii) për vitet 2006-2008, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë provuar marrjen e shumave të deklaruara në asnjë nga mënyrat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
- (iv) Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim “ISSh”) ka konfirmuar se subjekti “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën janar 2003 - nëntor 2006, ka deklaruar të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi pranë këtij institucioni, për shumën e të ardhurave *neto* në masën 311.447 lekë;
- (v) detyrimet tatimore nuk janë paguar në kohë dhe sipas shumave të deklaruara, por janë paguar gjatë procesit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, Komisioneri Publik ka vlerësuar se të ardhura të ligjshme nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, do të duhej të konsideroheshin vetëm të ardhurat *neto*, të konfirmuara nga institucionet shtetërore. Duke marrë për bazë këtë vlerësim, nga analiza financiare për vitet 2006, 2007 dhe 2008, Komisioneri Publik i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, shpenzimet dhe investimet e kryera, për një diferencë negative prej 2.389.419 lekësh.

18. Lidhur me këtë shkak të ankimit, në parashtrimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit argumentoi se pretendimet e Komisioneri Publik lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të pasurisë objekt kontrolli, janë të pabazuara. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

**18.1** Provat e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), dhe/apo të administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, dëshmojnë qartë për ekzistencën e marrëdhënies së punës dhe pagën që ka përfituar bashkëshorti i saj, si punëmarrës në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, pavarësisht faktit se marrëdhënia e punës është lidhur në mënyrë verbale.

**18.2** Përgjegjësia ligjore për përlogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen e detyrimeve tatimore bie mbi punëdhënësin, bazuar në legjislacionin e kohës. Personi i lidhur ka qenë në kushtet e padijenisë absolute, në mirëbesim lidhur me mospagimin e detyrimeve tatimore nga punëdhënësi, pasi paga është marrë gjithmonë e plotë ose është tërhequr me çeqe bankare ose është dhënë me mandatpagesë; nuk ka përfituar shërbim mjekësor të recetave të rimbursueshme të barnave nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor që të merrte dijëni se nuk ishin paguar sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe kjo provohet nga aktet e paraqitura prej saj gjatë gjykimit në Kolegj. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se me provat e paraqitura gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka arritur të provojë se bashkëshorti i saj nuk ka qenë në asnjë moment në dijëni, në keqbesim, nuk ka bashkëpunuar me punëdhënësit e tij për mospagimin e detyrimeve tatimore.

**18.3** Pretendimi i Komisionierit Publik se vlera e deklaruar e pagës nuk rezulton të ketë kaluar nëpërmjet sistemit bankar për vitet 2006-2008, nuk qëndron, pasi detyrimi që punëdhënësi t'ia paguajë pagën punëmarrësit vetëm nëpërmjet sistemit bankar është parashikuar si detyrim në vitin 2015, ndërkohë periudha kohore e ankimuar është 2006-2008.

**18.4** Paga *neto* është marrë në *cash* nga personi i lidhur nëpërmjet mandatpagesave, disa prej të cilave janë paraqitur në cilësinë e provës në Komision, një mënyrë e parashikuar nga legjislacioni në fuqi në atë kohë. Kartelat e llogarisë kontabël të pagës së bashkëshortit gjatë periudhës 2006-2008, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, përmbajnë informacion mbi datën e kontabilizimit të pagës, e cila përputhet me datat e mandatarkëtimeve të paraqitura si provë gjatë hetimit administrativ në Komision.

**18.5** Punëdhënësi, z. A. N., si agjent tatimor i detyruar nga ligji, në keqbesim, nuk ka paguar shumat e ndalesave nga paga, për të cilat bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur dijeni. Z. A. N. ka deklaruar që shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është në statusin “likuidim e sipër” dhe në këto kushte, ka rënë dakord me personin e lidhur për përmbushjen e detyrimit, për rrjedhojë bashkëshorti ka deklaruar të ardhurat me deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) për vitin 2011, si viti më i hershëm i deklarimit individual të të ardhurave, dhe punëdhësi ka paguar maksimalisht gjogat e gjeneruara dhe interesin për vonesë në pagesë.

**19.** Trupi gjykues, në shqyrtimin e shkakut të ankimit lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë “apartament banimi, me sipërfaqe 111,87 m<sup>2</sup> në {\*\*\*}, Tiranë”, pasi analizoi aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi sa më poshtë.

**19.1** Origjina e pasurisë objekt kontrolli rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes/porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.11.2006, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit e bashkëshortit të saj në cilësinë e porositësve dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në cilësinë e sipërmarrësit. Sipas parashikimeve kontraktore, vlera e përgjithshme e objektit të kontratës është 50.341 euro, nga të cilat, kësti i parë në shumën 25.000 euro është likuiduar më datë 15.11.2006. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka provuar se pagesat e tjera për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, janë kryer: 10.000 euro më datë 20.12.2007; 3.000 euro më datë 15.07.2008; 5.000 euro më datë 15.12.2008; si dhe 7.000 euro më datë 09.11.2009.

**19.2** Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burime të krijimit të kësaj pasurie: *Kursime nga të ardhurat nga pagat, hua në shumën 10.000 euro nga prindërit e bashkëshortit, A. dhe R. O., dhe 6.000 euro dhuratë nga motra e bashkëshortit, A. O.. Sqarim: Në datën e nënshkrimit të kontratës është paguar shuma prej 25.000 eurosh, nga të cilat 9.000 euro ishin kursime nga pagat, ndërsa pjesa prej 16.000 eurosh ishin dhurata nga kunata dhe huaja nga vjehrra dhe vjehrra. Pjesa tjetër prej 25.341 eurosh është paguar më pas me disa pagesa të cilat kanë përfunduar në vitin 2009 (10.000 euro në vitin 2007, 8.000 euro në vitin 2008 dhe 7.000 euro në vitin 2009). Nga huaja prej 10.000 eurosh, e marrë nga prindërit e*

*bashkëshortit, është shlyer një pjesë prej 5.000 eurosh dhe ka ngelur pa u shlyer pjesa prej 5.000 eurosh.*

20. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore të interesave, për periudhën 2006-2008, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. K. O., rezultojnë të jenë deklaruar të ardhurat nga punësimi, të pasqyruara si më poshtë.

20.1 Në deklaratën periodike të vitit 2006, në rubrikën “Të ardhurat dhe anagazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”: *Të ardhura nga paga si inxhinier ndërtimi në “{\*\*\*}” ShPK, ku objekt i saj është ndërtimi i rrugëve dhe pallateve. Pallat shumëkatësh prapa dy kullave binjake, Tiranë. Vlera 960.000 lekë.*

20.2 Në deklaratën periodike të vitit 2007, në rubrikën “Të ardhurat dhe anagazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”: *Të ardhurat nga paga si inxhinier ndërtimi te firma “{\*\*\*}” SRL, si zbatues projekti. Vlera 960.000 lekë.*

*Të ardhurat si drejtues teknik i firmës “{\*\*\*}” ShPK. Vlera 360.000 lekë.*

20.3 Në deklaratën periodike të vitit 2008, në rubrikën “Të ardhurat dhe anagazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”: *Drejtues teknik i firmës “{\*\*\*}” ShPK, me administrator M. N. Vlera 480.000 lekë.*

*Inxhinier zbatimi te firma “{\*\*\*}” ShPK, deri në muajin gusht të vitit 2008, me administrator A. N.. Vlera 640.000 lekë.*

*Inxhinier projektues te firma “{\*\*\*}”, me administrator E. M., nga muaji gusht 2008 e në vazhdim. Vlera 200.000 lekë.*

21. Në deklaratën e rivlerësimit, z. K. O. ka deklaruar: *Të ardhura nga paga në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën korrik 2002 - gusht 2008, me pagë mujore 80.000 lekë. Vlera 5.840.000 lekë.*

21.1 Bashkëlidhur deklaratës së sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin, pa datë, të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nënshkruar nga administratori z. A. N.. Sipas këtij vërtetimi, z. K. O. ka punuar pranë shoqërisë në fjalë si inxhinier ndërtimi, nga periudha korrik 2002 deri në gusht 2008. Gjatë kësaj periudhe kohore, ai është angazhuar me kohë të plotë me detyra të ndryshme, si inxhinier zbatimi, drejtues kantieri, menaxher projekti etj. Paga mujore e tij, gjatë kësaj periudhe, ka qenë 80.000 lekë.

22. Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSh-së, në informacionin e përcjellë në Komision me shkresë nr. 8509 prot., datë 12.09.2019, sipas vërtetimit mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, ka vërtetuar se z. K. O.: [...] *për periudhën prej janarit 2003 deri në nëntor 2006, ka realizuar të ardhura në shumën 543.668 lekë, mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi në subjektin “{\*\*\*}” me nr. dosje {\*\*\*} [...]. Shënim: Për periudhën korrik 2002 deri tani, nuk administrojmë listëpagesa. Për periudhën gusht - dhjetor 2002 nuk i figuron emri në listëpagesa. Ndërsa: për periudhën prej marsit 2007 deri në prill 2007, ka realizuar të ardhura në shumën 97.222 lekë, mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi në subjektin “{\*\*\*}” me nr. dosje {\*\*\*} [...].*

23. Në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të përmbledhur, se: [...] Referuar shkresës me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.05.2019, të ISSh Tiranë, rezulton se për vitin kalendarik 2002, bashkëshorti im nuk është deklaruar fare nga ky punëdhënës, kur në të vërtetë rezulton se ka qenë në marrëdhënie pune. [...] Përcaktimi i pagës referencë në vitin 2007, në shumën 120.000 lekë, duke rillogaritur indeksimin e pagave sipas normës së inflacionit për vitet 2006-2007 (sipas burimit: Banka e Shqipërisë, inflacioni historik në këtë kohë ka qenë 2,5% dhe 3,1%), rezulton se paga bruto në vitin 2006, për këtë pozicion pune, nuk duhet të jetë më pak se 116.340 lekë/muaj dhe paga neto mujore 98.731 lekë/muaj. Ajo që vihet re nga kronologjia e pagesave nga punëdhënësi “{\*\*\*}” ShPK të kryera pranë ISSh Tiranë, është fakti se sa herë ka ndryshuar paga minimale mbi bazën e së cilës duhej të paguhej detyrimi/kontributi, po në këtë mënyrë është ndryshuar dhe deklarimi i pagesës për bashkëshortin tim, ku kjo është një metodologji e ndjekur nga punëdhënësi i tij dhe nuk lidhet me asnjë veprim të qëllimshëm dhe dijeni nga ana e bashkëshortit tim, i cili në këtë rast është i dëmtuar. Për më tepër, gjatë periudhës së detyrimit për aplikimin e pagës referencë të vendosur nga ligjvënësi, punëdhënësi nuk e deklaroi dhe nuk paguan më kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, duke ndërprerë dhe faktimin e marrëdhënies së punës gjatë periudhës së kohës 2007-2008, që përkon me ndërtimin e dy objekteve në {\*\*\*}, Kavajë. [...] në total për vitin 2003, unë provoj se bashkëshorti im ka tërhequr shumën prej 1.100.000 lekësh, ku këtu përfshihen dhe shpenzimet që bashkëshorti im ka pasur për shkak se ka punuar në qytetin e Kukësit, në lidhje me mirëmbajtjen e rrugës [...].Pra, rezulton se bashkëshorti im për vitin 2003, ka marrë pagën 1.100.000 lekë (pagë dhe rimbursim shpenzimesh), për vitin 2004 ka marrë pagën e 920.000 lekë, për vitin 2005, 160.000 lekë, referuar provave që ne kemi mundur të sigurojmë, pasi krahas pagesës me çek, një pjesë e tyre janë kryer dhe duke u dhënë në dorë, “cash”. [...] Gjatë periudhës së punësimit pranë kësaj shoqërie, bashkëshorti im ka përfiturar të ardhura nga punësimi në shumën 80.000 lekë/muaj neto. Referuar bazës ligjore të trajtuar më lart, nga ana e punëdhënësit janë bërë ndalesat për pjesën që punëmarrësi paguan për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe ndalesa për tatimin mbi të ardhurat personale. Përfitimi nga të ardhurat bruto çdo muaj, të realizuara nga bashkëshorti im, në vitin 2006, kanë qenë 92.007 lekë dhe 94.304 lekë, në vitin 2007 paga bruto 94.304 lekë dhe 97.065 lekë dhe në vitin 2008, paga bruto 97.065 lekë dhe 98.116 lekë. Por ndërkohë, nga të ardhurat bruto nga paga, janë bërë ndalesat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi të kohës dhe bashkëshorti im ka përfiturar të ardhurat neto në shumën 80.000 lekë. Duket qartë që detyrimi tatimor dhe kontributi për pjesën që paguan punëmarrësi janë mbajtur nga ana e punëdhënësit, i cili është përgjegjës për derdhjen në organet tatimore të detyrimeve dhe kontributeve përkatëse. Mbas prezantimit të kësaj problematike dhe verifikimit nga ana e tij me dokumentacionin që posedonte, mori përsipër të paguajë detyrimin tatimor për të ardhurat personale për periudhën janar 2006 - gusht 2008 për bashkëshortin tim, pasi i referuam që në të kundërt do t'i drejtoheshim me padi civile Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ashtu siç kishim vendosur për subjektet e tjera dhe për të cilat e ndërmorëm si hap ligjor më pas. Ai na bëri me dije se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ishte në status likuidim e sipër, procedurë që nuk është mbyllur për shkak të mospagesës së detyrimeve të taksave vendore. [...] Të ndodhur në këtë situatë, bashkëshorti im, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ka

deklaruar më datë 14.11.2019, “Deklaratën Individuale të të Ardhurave për vitin 2011” me të ardhurat bruto të realizuara për periudhën janar 2006 deri në gusht 2008, në shumën totale 3.037.512 lekë, duke llogaritur tatimin mbi të ardhurat që duhej paguar, që rezulton nga diferenca midis totalit të tatimit të llogaritur për të gjitha llojet e të ardhurave të tatueshme me shumën e tatimeve të paguara, të dokumentuara nga mbajtësi në burim i këtyre tatimeve, përfaqëson shumën e tatimit për t’u paguar nga individi. [...] Më datë 15 nëntor 2019, shtetasi A. N. ka derdhur pranë llogarisë personale të bashkëshortit tim në bankën BKT, shumën 444.624 lekë, me përshkrim veprimi: “{\*\*\*} ShPK derdhje për pagesë TAP 1 jan 2006 - 31 gusht 2008”. Me shumën e derdhur nga z. A. N., bashkëshorti im ka kryer po në datë 15 nëntor 2019, pagesën për detyrimin e tatimit për pagat e realizuara nga ai në këtë periudhë. Bashkëshorti im pas këtij veprimi ka deklaruar me deklaratën individuale vjetore të të ardhurave për vitin 2011, si viti më i hershëm i deklarimit individual të të ardhurave, duke paguar maksimalisht gjobat e gjeneruara dhe interesin për vonesë në pagesë. Në kuptim të parashikimit të paragrafit 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, mbas pagesës së detyrimit tatimor, këto janë të ardhura të ligjshme, të tatuara dhe Komisioni duhet t’i njohë si të tilla. Në lidhje me sigurimet shoqërore, [...] këto kontribute sipas deklaratës noteriale me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 19.11.2019, janë marrë përsipër të paguhen nga ortaku i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. A. N., në një kohë sa më të afërt. Gjithashtu, në këtë deklaratë noteriale shtetasi A. N. konfirmon faktin se paga neto mujore që bashkëshorti im është paguar gjatë marrëdhënies së punës korrik 2002 - gusht 2008, ka qenë në shumën 80.000 lekë dhe ai ka deklaruar se është i gatshëm që këtë fakt ta pohojë nën përgjegjësinë e tij edhe përpara anëtarëve të Komisionit.

Në kuadër të shpjegimeve të sipërcituara, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), për të provuar marrëdhënien e punës së bashkëshortit të saj si inxhinier ndërtimi, në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, ka depozituar gjatë hetimit administrativ në Komision, një sërë dokumentesh të shoqërisë në fjalë, në të cilat citohet emri i z. K. O. ose që janë nënshkruar prej këtij të fundit, si punonjës i kësaj shoqërie, si procesverbale mbledhësh të zhvilluara mes përfaqësuesve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe shoqërisë “{\*\*\*}” Inc.; shkresa të nënshkruara nga z. K. O. drejtuar shoqërisë “{\*\*\*}” Inc., në të cilat referohen problematika në lidhje me realizimin e punimeve në rrugën “{\*\*\*}” e në rrugën “{\*\*\*}”; vendime të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë {\*\*\*} për miratim leje ndërtimi, me investitor shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK e procesverbale të përfundimit të fazave të ndryshme të ndërtimit në këtë zonë, të nënshkruara nga z. K. O.; licenca e ushtrimit të profesionit lëshuar nga ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit për z. K. O. etj.

24. Për të provuar pagesat e kryera nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ndaj bashkëshortit të saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), ka paraqitur mandatpagesat për disa muaj, për pagat në shumën 80.000 lekë/muaj, të paguara përkatësisht më datë 28.09.2006; datë 01.11.2006; datë 06.11.2007; datë 27.12.2007; datë 03.03.2008.
25. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të dhëna nga Banka Intesa San Paolo Bank, lidhur me tërheqje shumash, të kryera referuar çeqeve bankare të emetuara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK,

sipas të cilave bashkëshorti i saj, z. K. O., ka tërhequr shuma të ndryshme, për periudhën 2003-2005<sup>9</sup>.

26. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe deklaratën noteriale të z. A. N., me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.11.2019, në të cilën ai deklaroi se: *[...] shtetasi K. O. ka qenë i punësuar si inxhinier ndërtimi në periudhën korrik 2002 deri në gusht 2008, me pagë neto 80.000 lekë në muaj, e cila për shkak të kushteve të shoqërisë, Shqipërisë dhe legjislacionit të kohës, është paguar me para në dorë një pjesë dhe një pjesë me çeqe bankare nga financa e shoqërisë. Deklarimi i pagës në organet shtetërore dhe pagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është bërë duke iu referuar pagës minimale, siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi, por ky deklarim për vlerën e pagës për të punësuarin K. O., nuk ka qenë real, pasi është nënvlerësuar nga shoqëria. Vlera reale e pagës së paguar për punën pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, për të punësuarin K. O., me detyrën e inxhinierit, e ripërsëris se ka qenë 80.000 lekë në muaj, paga neto. Mbas referimit dhe konsultimit me dokumentacionin e shoqërisë, për shkak të pamundësisë reale që ky subjekt juridik ka, pasi është në status “likuidimi e sipër” dhe nga ana e likuidatores është dorëzuar raporti përfundimtar i prishjes dhe likuidimit të shoqërisë në QKB, dhe prej kësaj kohe nuk janë kryer më deklarime, kam përmbushur detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale referuar pagës bruto dhe neto 80.000 lekë në muaj, për periudhën janar 2006 - gusht 2008, duke i kaluar në llogarinë bankare pranë BKT-së Tiranë, shumën prej 444.624 lekësh, që përbën principalin e detyrimit tatimor, gjopa dhe kamatëvonesa për pagesë me vonesë të detyrimit tatimor. Në lidhje me përmbushjen e derdhjes së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kam rënë dakord që t’i paguaj në një kohë sa më të afërt, duke llogaritur dhe paguar këtë detyrim referuar pagës mujore neto në shumën 80.000 lekë në muaj.*

**26.1** Bashkëlidhur deklaratës noteriale, deklaruesi ka paraqitur mandatin bankar të Bankës Kombëtare Tregtare, datë 15.11.2019, sipas të cilit z. A. N. ka derdhur cash në llogarinë e z. K. O., shumën 444.624 lekë, me përshkrimin: “{\*\*\*}” ShPK, derdhje për pagesë TAP 1 janar 2006 - gusht 2008, në llogari të K. R. O., arkitekt A. N..

---

<sup>9</sup> Në datë 11.08.2003, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 400.000 lekësh, referuar çekut bankar me numër {\*\*\*}, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

Në datë 02.12.2003, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 700.000 lekësh, referuar çekut bankar me numër {\*\*\*}, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

Në datë 14.04.2004, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 120.000 lekësh, referuar çekut bankar me numër {\*\*\*}, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

Në datë 30.08.2004, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 100.000 lekësh, referuar çekut bankar me numër {\*\*\*}, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

Në datë 23.09.2004, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 200.000 lekësh, referuar çekut bankar me numër {\*\*\*}, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

Në datë 28.10.2004, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 500.000 lekësh, referuar çekut bankar me numër {\*\*\*}, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

Në datë 07.04.2005, z. K. O. ka tërhequr shumën prej 160.000 lekësh, referuar çekut bankar me numër {\*\*\*}, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

27. Shumën e sipërcituar, z. K. O., e ka tërhequr në po të njëjtën datë dhe me të ka kryer nëpërmjet Bankës Credins, në favor të operatorit “Tatime dhe sigurime”, pagesën në shumën 444.624 lekë, me përshkrimin: *Tatim mbi të ardhurat individuale, janar-dhjetor 2011*. Kjo pagesë është kryer në bazë të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) për vitin 2011, deklaruar nga z. K. O., më datë 14.11.2019. Z. K. O. ka deklaruar të ardhura bruto në shumën 3.037.512 lekë dhe sistemi i ka gjeneruar si tatim të detyrueshëm për t’u paguar, shumën prej 252.137 lekësh. Sipas Urdhër Pagesës {\*\*\*}, “Tatimi mbi të ardhurat individuale”, gjeneruar nga sistemi tatimor pas dorëzimit të DIVA-s, detyrimet që duhet të paguante z. K. O. ishin: 252.137 lekë detyrim principal, 60.218 lekë gjobë dhe 132.269 lekë interes. Në total, vlera e detyrimit për t’u paguar ka qenë në shumën 444.624 lekë.
28. Me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 10.12.2019, me lëndë: “Kërkesë për opinion ligjor”, Komisioni i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve opinion ligjor: i) për veprimet e z. A. N. në cilësinë e ish-administratorit të një shoqërie, e cila është në likuidim; ii) mbi vlefshmërinë e deklarimit të formularit DIVA për vitin 2011, nga z. K. O., i dorëzuar më datë 14.11.2019, ku përfshihen të ardhurat e përfituara nga kjo kompani për vitet 2006-2008. Me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 23.12.2009, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka shpjeguar se: “Në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 37 përcaktohej se: “Tatimet janë të detyrueshme për t’u paguar në afatet e përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore”. Referuar kuadrin ligjor të sipërcituar, deklarimet duhet të ishin bërë në afatet e përcaktuara nga ligji. Për sa i takon vlefshmërisë së deklarimit të formularit DIVA për vitin 2011, nga z. K. O., i cili ka deklaruar dhe paguar me formularin DIVA në vitin 2019, të ardhurat e viteve 2006-2008 dhe jo në periudhën përkatëse, ju bëjmë me dije se legjislacioni tatimor njeh të drejtën e deklarimit me vonesë, duke paguar interesat dhe penalitetet, por gjatë viteve ka pasur shkallë tatimore të ndryshme të përcaktuara nga ligji. [...] llogaritja, deklarimi dhe pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga shtetasi A. N., në cilësinë e ortakut dhe administratorit të vetëm të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK nuk është bërë sipas kërkesave ligjore”.
29. Më datë 20.02.2020, Komisioni ka marrë dëshminë e z. A. N., ish-administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK “në likuidim”<sup>10</sup>, i cili, në përgjigje të pyetjeve të drejtuara nga Komisioni, ka deklaruar: [...] *Kemi bërë një marrëveshje me një studio për të mbajtur aktivitetin ekonomik financiar, “{\*\*\*}”, dhe këto gjëra unë i mora vesh kur jam kontaktuar nga inxhinieri dhe na u desh të verifikonim për pagesat, tatimet. [...] për K. u interesova dhe është paguar me një rrogë, me çeqe bankare deri në vitin 2006, me aq sa mbaj mend unë. [...] ne ndërtoam në {\*\*\*} dy objekte civile për të cilat është kujdesur inxhinieri që ka kontrolluar punimet. Pagesa është bërë me*

---

<sup>10</sup> Sipas Raportit të Mbylljes së Likuidimit, datë 15.10.2012, të hartuar nga likuidatorja F. Sh. [eksperte kontabël e regjistruar], shoqëria “{\*\*\*}” ShPK nuk ka, ndër të tjera, detyrim për të ardhura personale dhe sigurime shoqërore dhe as detyrime ndaj degës së Tatim Taksave, Tiranë, për rrjedhojë nuk ka asnjë detyrim si me shtetin, ashtu dhe me të tretët me rastin e likuidimit. Në konkluzion, likuidatorja ka arritur në përfundimin që shoqëria “{\*\*\*}” ShPK “Të likuidohet”, pasi nuk ka probleme financiare. Me vendimin nr. 3, datë 20.10.2012, të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. A. N., është vendosur prishja e shoqërisë.

*mandate "cash". [...] Mandatet janë nënshkruar vetëm nga unë. Unë ia kam vënë në dispozicion inxhinierit çfarë kam gjetur, besoj se ai i ka depozituar te ju. [...] Paga në tërësi e tij ka qenë 80.000 lekë. Pastaj ai paguante të tjerat. Ne kemi pasur një shoqëri financiare dhe e kanë bërë ato punën dhe nuk kam aftësi të kthehem 20 vjet përpara dhe të kujtoj.*

30. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), përveç se rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me marrëdhënien e punësimit dhe pagën e përfituar nga bashkëshorti i saj në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, për të mbështetur pretendimet e saj, paraqiti aktet e administruara në cilësinë e provës, si vijojnë.

30.1 Shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.12.2021, të Ujësstellës Kanalizime ShA, Kavajë, sipas së cilës, në arkivën e saj, për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me administrator z. A. N., disponohet kërkesë e datës 31.03.2008, e inxhinierit K. O., për realizimin e pikave lidhëse të rrjetit të ujësstellës për dy godina në {\*\*\*}, të ndërtuara me investitor z. A. N., si dhe autorizim i lëshuar nga administratori i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, pa datë, me vulën e shoqërisë për inxhinierin K. O., me qëllim paraqitjen e kërkesave pranë institucioneve publike për pajisjen me ujë dhe energji për dy godinat e ndërtuara në {\*\*\*}, sipas albumit të ndarjes në apartamente për objektet e ndërtuara.

30.2 Kartelat e llogarive të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK për “Paga dhe shpërblime K. O.”, printuar nga sistemi *Alpha Bussines*, për periudhat 01.01.2006 - 31.12.2006; 01.01.2007 - 31.12.2007; 01.01.2008 - 31.08.2008, sipas shënimeve të të cilave është kontabilizuar paga për secilin muaj të periudhave të sipërcituara, në vlerën 80.000 lekë/muaj.

30.3 Shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.12.2021, të Drejtorisë së Arkivit Qendror të ISSh-së, vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, sipas të cilit, për z. A. N., administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, janë realizuar të ardhura në shumën 543.668 lekë, për periudhën prej korrikut 2002 deri në prill 2007, mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi në subjektin “{\*\*\*}” ShPK, me nr. dosje {\*\*\*}. Sipas të dhënave të vërtetimit të sipërcituar, i punësuar në shoqëri ka qenë edhe z. C. B., për të cilin periudha për të cilën janë realizuar të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi, përkon me atë të z. K. O..

30.4 Shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 12.01.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, sipas së cilës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka derdhur pagat mbi të cilat janë paguar kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, si dhe detyrimet tatimore për tre punonjës, për periudhën janar 2006 - dhjetor 2007.

- 31 Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, në raport me shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit mbi to, trupi gjykues vlerësoi si vijon.
- 32 Në referim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm jo vetëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara, por edhe të të ardhurave. Nën dritën e këtij parashikimi kushtetues, si dhe vlerësimit të Kolegjit në



jurisprudencën e konsoliduar prej tij për raste të ngjashme<sup>11</sup>, standardi i vendosur nga kjo dispozitë, për përcaktimin e ligjshmërisë së të ardhurave, kërkon që ato të jenë krijuar nga burime të ligjshme, të jenë deklaruar dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik, në analizë të pretendimeve dhe akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, në konkluzionet përfundimtare<sup>12</sup>, ka parashtruar se: [...] nuk kontestohet ekzistenca e marrëdhënies së punësimit mes personit të lidhur dhe shoqërisë në fjalë, as dhe fakti se detyrimi ligjor për shlyerjen e detyrimeve tatimore bie mbi punëdhënësin. Sikundër, sa kohë në situata të ngjashme të marrëdhënies së punësimit me shoqëri të tjera, me vendime gjyqësore të formës së prerë, është gjetur e provuar mungesa e dijenisë së personit të lidhur me këtë rrethanë faktike, parë në harmoni dhe me provat e reja të administruara gjatë këtij gjykimi, edhe kjo rrethanë në këtë marrëdhënie punësimi gjendet e provuar.

Në vijim, Komisioneri Publik ka pretenduar se në kushtet kur: (i) mungon një akt i shkruar që të provojë rregullimin e marrëdhënies financiare midis palëve në lidhje me vlerën e pagesës; (ii) punëdhënësi ka kryer pagesa të detyrimeve tatimore mbi të ardhura minimale të përfituara në formën e pagës mujore; (iii) deklaratimet e z. A. N. mbi të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore; ai ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive të kontrollit dhe përcaktimit të vlerës reale mujore dhe tërësore të kësaj të ardhure të pretenduar si të përfituar dhe deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike e, për pasojë, të llogaritjes së të ardhurave reale të realizuara gjatë viteve 2006-2008, nga kjo marrëdhënie punësimi.

- 33 Në shqyrtim të këtyre pretendimeve të Komisionerit Publik, trupi gjykues analizoi faktet dhe rrethanat e konstatuara si më sipër, dhe vlerësoi në harmoni si vijon.

*Së pari*, gjatë gjykimit në Kolegj rezultoi e provuar:

(i) ekzistenca e vazhdueshme e marrëdhënies së punësimit mes personit të lidhur dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në kushtet kur, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ dhe gjatë gjykimit në Kolegj, u provua puna konkrete/përgjegjësitë e personit të lidhur, në kuadër të rregullave dhe organizimit të shoqërisë, si dhe shpërblimi/paga e vazhdueshme për punën e kryer në periudhën në fjalë;

(ii) mungesa e dijenisë së personit të lidhur për mospërbushjen nga punëdhënësi të pagesës së detyrimeve tatimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar<sup>13</sup>, mbi masën e pagës së deklaruar nga

<sup>11</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 23/2020 (JR); nr. 6/2019 (JR); nr. 07/2019 (JR); nr. 19/2019 (JR) etj.

<sup>12</sup> <https://ikp.al/wp-content/uploads/2020/10/Bisedimet-p%3c3%abrfundimtare-dat%3c3%ab-3.2.2023.pdf>

<sup>13</sup> Në nenin 10, “Mbledhja e tatimit”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcaktohet: “1. Çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në germen “a” të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9 të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës. 2. Të gjithë punëdhënësit mbajnë regjistrime të pagesave të specifikuara në germen “a” të nenit 8 të këtij ligji, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave. 3. Të gjithë punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar janë të detyruar të deklarojnë tatimin mbi të ardhurat vetjake, të mbajtur në burim për punëmarrësit. Forma, përmbajtja, afatet dhe procedurat e dorëzimit të deklaratave përcaktohen në udhëzimin e ministrit të Financave të nxjerrë në zbatim të këtij ligji”.

personi i lidhur, e cila e përjashton atë nga të qenit në kushtet e keqbesimit në raport me sjelljen e palës punëdhënëse.

*Së dyti*, deklarimi i të ardhurave të përfituara nga punësimi në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, nuk është një deklarim i posaçëm i kryer nga subjekti i rivlerësimit vetëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por ka qenë një deklarim i bërë rregullisht, në deklaratat periodike vjetore, duke filluar nga viti 2006, vit në të cilin z. K. O. ka fituar cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të lidhjes së martesës, më datë 30.12.2005;

*Së treti*, për muajt shtator e nëntor të vitit 2006, nëntor e dhjetor të vitit 2007 dhe për muajin mars të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur mandatpagesat e lëshuara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, sipas të cilave paga mujore *neto* e lëvruar nga punëdhënësi ka qenë në masën 80.000 lekë. Kjo shumë dhe datat përkatëse të lëvrimit të shënuara në mandatpagesa, konfirmohen edhe nga të dhënat e kartelave të llogarive të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, printuar nga sistemi *Alpha Bussines*, dhe paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj. Pagesat e pagave mujore në *cash*, ishin një formë e njohur nga legjislacioni në fuqi i kohës, sipas parashikimeve të nenit 118, pika 1 e Kodit të Punës<sup>14</sup>.

*Së katërti*, të dhënat e rezultuara nga përmbajtja e shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 12.01.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore nga shoqëria “{\*\*\*}” ShKP për tre punonjës, për periudhën janar 2006 - dhjetor 2007, të verifikuara të kryqëzuara me të dhënat e rezultuara nga përmbajtja e shkresave nr. {\*\*\*} prot., datë 12.09.2019 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 16.12.2021 të Drejtorisë së Arkivit Qendror të ISSh-së, sipas të cilave nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është derdhur kontributi për dhjetë muaj në vitin 2006 dhe për dy muaj në vitin 2007, mbi të ardhurat e realizuara vetëm për tre punonjës, përkatësisht për z. A. N., z. C. B dhe z. K. O., krijojnë bindjen se nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK janë paguar detyrimet tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga z. K. O., për të gjithë periudhën janar 2006 - dhjetor 2007. Ky konkluzion ndikohet edhe nga statusi i qartë i personit të lidhur në raport me shoqërinë në fjalë, i provuar gjatë gjykimit, si i punësuar në një marrëdhënie të vazhdueshme punësimi.

*Së pesti*, nga verifikimi i pagesave të pagës me çek bankar, për periudhën 2003-2005, sipas tërheqjeve të tyre nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, të konfirmuara nga të dhënat e përcjella në Komision nga Banka Intesa San Paolo, rezultoi se z. K. O. është paguar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, mesatarisht, në shumën rreth 80.000 lekë/muaj.

Bazuar në vlerësimin si më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i Komisionerit Publik është i pabazuar në fakte dhe në ligj, pasi rrethanat e mësipërme mundësonin përlllogaritjen

---

*Në nenin 6 të ligjit 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet: “1. Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur. 2. Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit [...]”.*

<sup>14</sup> *Neni 118 i Kodit të Punës, me titull “Mënyra e pagesës”, pika 1 parashikonte se: “1. Paga duhet të paguhet në monedhë shqiptare, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe nga marrëveshja ndërmjet palëve. Ajo mund të paguhet edhe me çek bankar, çek postar ose urdhër pagese, kur kjo lloj pagese është e nevojshme për shkak të rrethanave të veçanta ose kur parashikohet në kontratën kolektive a në një vendim arbitrazhi. Kur kjo lloj pagese nuk është parashikuar ose vendosur, merret pëlqimi i punëmarrësit të interesuar. Punëdhënësi përgjigjet financiarisht ndaj punëmarrësit, kur banka nuk mund të paguajë brenda 30 ditëve nga data e derdhjes së shumës, për llogari të punëmarrësit”.*

e të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në vitet 2006 dhe 2007.

- 34 Në vijim të arsytimit si më sipër e në mbështetje të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në përlllogaritjen e të ardhurave të personit të lidhur nga punësimi në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues konsideroi: a) të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit për periudhën janar 2006 - dhjetor 2007, në masën e rezultuar nga të dhënat e dokumentuara në shkresat zyrtare të Drejtorisë së Arkivës Qendrore të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë; b) për muajt shtator, tetor, nëntor 2006, dhe nëntor e dhjetor 2007, si dhe mars 2008, masa e të ardhurave sipas të dhënave zyrtare u zëvendësua me masën 80.000 lekë/muaj, sipas të dhënave të mandatpagesave të lëshuara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK për personin e lidhur.
- 35 Për muajt e mbetur të vitit 2008, në kushtet kur nga dokumentacioni i përcjellë nga institucionet shtetërore nuk rezultojnë të dhëna për të ardhura të realizuara nga personi i lidhur, mbi të cilat të jetë paguar kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe detyrimi tatimor në kohën e ekzistencës së marrëdhënies së punësimit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, si dhe nga subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur dokumentacion provues për dhënien e pagave nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK kundrejt z. K. O. [çek, mandatpagesë ose pagesë nëpërmjet sistemit bankar], trupi gjykues vlerësoi të mos përlllogarisë të ardhura në favor të personit të lidhur. Në këtë arsyetim, trupi gjykues u mbështet edhe në qëndrimin tashmë të konsoliduar të mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit, në interpretim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, lidhur me vlerësimin e të ardhurave të ligjshme<sup>15</sup>. Në total, të ardhurat nga pagat e përfituara nga punësimi në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, të cilat do të konsiderohen nga trupi gjykues në analizën financiare për verifikimin e mundësisë së krijimit të pasurisë objekt kontrolli, janë në shumën 912.212 lekë.
- 36 Në lidhje me të ardhurat nga punësimi i personit të lidhur në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues vëren se në deklaratat periodike të vitit 2007 e 2008, si dhe në deklaratën e rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar rregullisht përfitimin e tyre.

**36.1** Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur kontratë pune nr. {\*\*\*} rep., datë 10.05.2007, të lidhur mes z. K. O. në cilësinë e punëmarrësit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga administratori dhe ortaku i vetëm z. M. N. Sipas parashikimeve kontraktore, palët kishin rënë dakord që pagesa të ishte 50.000 lekë/muaj dhe se punëdhënësi do të bënte pagesën e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

**36.2** Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSh-së, në informacionin e përcjellë në Komision, me vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 12.09.2019, vërteton se: “Për z. K. O., për subjektin “{\*\*\*}”, me nr. dosje {\*\*\*}, pas verifikimit, vërtetojmë se nuk i figuron emri për periudhën qershor 2007 - maj 2009. Për muajin maj 2007 deri tani nuk disponojmë listëpagesa”.

---

<sup>15</sup> *Shih vendimet e Kolegjit nr. (JR) 15/2021, datë 18.06.2021; nr. (JR) 35/2022, datë 22.09.2022; etj.*

**36.3** Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision padinë e depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datë 05.03.2020, nga z. K. O., me palë të paditur shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale për periudhën 10.05.2007 deri në datën 10.05.2008”.

- 37** Në vendim, Komisioni ka arsyetuar se: *Ndërsa lidhur me pretendimet e subjektit mbi provueshmërinë e burimit të ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga punësimi në dy shoqëritë e tjera “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues [...] çmon se duke i qëndruar konkluzionit se për efekt të këtij vlerësimi, provueshmëria e burimit të ligjshëm të të ardhurave të përfituara, vijoi të mbetet në nivel deklarativ, parë nën dritën e objektivitetit dhe proporcionalitetit, për sa kohë çështjet janë ende objekt gjyqësor, vlerëson se zgjidhja përfundimtare do të ishte e parakohshme. Edhe pse duke mos llogaritur në analizë financiare këto të ardhura, trupi gjykues konstaton se balanca negative shtrihet vetëm në vitin 2008 dhe pasqyron relativisht vlerë të ulët, që për nga pikëpamja e vlerësimit tërësor nuk merr peshë.*
- 38** Gjatë gjykimit në Kolegj, u administrua në cilësinë e provës vendimi nr. {\*\*\*}, datë 28.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit. Ky vendim ka për objekt detyrimin e palës së paditur “{\*\*\*}” ShPK, të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 10.05.2007 deri më datë 10.05.2009, kundrejt paditësit K. O.. Me këtë vendim, gjykata ka pranuar padinë e paditësit K. O. dhe detyrimin e palës së paditur “{\*\*\*}” ShPK, të paguajë për llogari të paditësit kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e sipërcituar. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 23.09.2022 dhe është dorëzuar për ekzekutim pranë përmbartës gjyqësor<sup>16</sup>. Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se: [...] *përmbajtja e marrëdhënies së punës ndërmjet palës paditëse dhe të paditurit del e qartë nga kontrata e punës nr. {\*\*\*} rep., datë 10.05.2007, në të cilën pasqyrohet objekti dhe detyrimet në raport me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit, palë e paditur, afati i kohëzgjatjes së kontratës 10.05.2007 -10.05.2009, si dhe paga e punëmarrësit në shumën 50.000 lekë [...].*
- 39** Në konkluzionet përfundimtare, në gjykimin në Kolegj, Komisioneri Publik parashtroi: *Në rrethanat faktike dhe ligjore të dala gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, vlerëson se të ardhurat me burim kursime nga paga nga marrëdhëniet e punësimit të dokumentuara me kontrata shkresore pune, midis personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, z. K. O., me shoqëritë e sipërlistuara, plotësojnë kushtet e përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe konsiderohen si të ardhura të ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit.*
- 40** Komisioneri Publik, në përfundim të hetimit gjyqësor e pasi analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka vlerësuar se pretendimet e paraqitura prej tij në ankim, lidhur me të

---

<sup>16</sup> Sipas vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 11.01.2023, të Shërbimit Përmbartës Tiranë, të paraqitur në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj.

ardhurat e përfituara nga personi i lidhur nga punësimi në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, morën zgjidhje nga hetimi gjyqësor dhe u konsideruan se nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimit të Komisionit. Ky vlerësim u gjet i drejtë edhe nga trupi gjykues, duke arritur në konkluzionin se të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në shoqërinë në fjalë, në shumën 993.000 lekë, duhet të konsiderohen në analizën financiare për verifikimin e mundësisë së krijimit të pasurisë objekt kontrolli.

- 41 Nga analiza financiare e kryer në Kolegj mbi konkluzionet e arritura nga arsyetimi si më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme, pagesat për blerjen e pasurisë “apartament banimi me sipërfaqe 111,87 m<sup>2</sup>”, ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë dhe shpenzimet e investimet e kryera, për dy vitet 2006 dhe 2008, në shumën totale prej 739.804 lekësh, duke u gjendur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- 42 Trupi gjykues, në vlerësim të rezultatit të prodhuar nga analiza financiare për pasurinë objekt kontrolli, vëren se diferenca negative që tregon pamundësinë financiare për të mbuluar me burime të ligjshme pagesat për blerjen e apartamentit, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera në dy vite të periudhës së marrë në analizë, është afektuar tërësisht nga mënyra e përlllogaritjes së të ardhurave nga pagat e përfituara nga personi i lidhur nga marrëdhënia e punësimit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, i cili ishte dhe pretendimi thelbësor i Komisionerit Publik, lidhur me këtë pasuri. Duke vlerësuar se e ardhura e përlllogaritur si e përfituar nga personi i lidhur, mbështetur në arsyetimin si më sipër, nuk është e ardhura reale, por e ardhura e përfituar më së paku prej tij, trupi gjykues evidenton se nuk përjashtohet mundësia që paga e përfituar të ketë qenë në vlerën e deklaruar në deklaratat periodike dhe atë të rivlerësimit, e në këtë rast mungesa e burimeve të ligjshme për periudhën objekt kontrolli, do të ishte dukshëm më e ulët, sesa ajo e rezultuar nga analiza financiare.
- 43 Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe, rrjedhimisht, nuk mbulon me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurive: apartament banimi në {\*\*\*}, Kavajë dhe automjet tip “Audi A2”, për një diferencë negative, deri në datën 16.04.2011, prej 849.435 lekësh*, trupi gjykues konstatoi sa më poshtë.
- 44 Komisioni, në vendim, lidhur me pasuritë e sipërcituara, ka arritur në konkluzionet se subjekti i rivlerësimit, për pasurinë apartament banimi në {\*\*\*}, Kavajë: (i) *ka shpjeguar bindshëm dhe ka faktuar me prova burimin e krijimit të shumës 5.125.734 lekë, shumë e krijuar nga të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit në shoqërinë “{\*\*\*}, E. M. M.”; (ii) ka bërë deklaram të mjaftueshëm në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës; (iii) rezulton në balancë pozitive për krijimin e kësaj pasurie.* Për pasurinë automjet, tip “Audi A2”: *[...]ka kryer deklaram të mjaftueshëm lidhur me këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj, ka pasur mundësi financiare, si dhe ka provuar burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit.* Komisioni, në arritjen e këtyre konkluzioneve, ka arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

Për pasurinë apartament banimi në {\*\*\*}, Kavajë<sup>17</sup>: [...] Trupi gjykues vlerëson në harmoni të gjitha faktet e pakontestueshme që përbëjnë burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i subjektit si i punësuar pranë shoqërisë “{\*\*\*}”, ku renditen: (i) pagesat e tatimit në burim të bëra në vitet kur edhe janë përfituar të ardhurat, pra, nga viti 2008 - 2012; (ii) shuma e tatimit në burim rakordon me të ardhurat e përfituara; (iii) pagesa përbën tatimin që shteti taton individin/subjektin në masën prej 10 % të shumës së të ardhurave dhe se në këtë rast, tatimi i paguar konfirmohet në total për detyrimin principal prej 5.695.260 lekësh; si dhe (iv) faktin se pagesat e bëra janë bërë në përputhje me parashikimin kontraktor, ku citohet se bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar me kohë të pjesshme, çka nënkupton se ka ofruar shërbime të caktuara, përforcuar kjo edhe me përshkrimin e bërë në shkresën e DRT-së Tiranë, ku citohet se pagesat janë kryer për llogari të z. K. O., me të cilin ka qenë lidhur kontratë nga punëdhënësi Person Fizik “{\*\*\*}”. Për të gjithë arsyet e lartpërmendura, trupi gjykues çmon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi të ardhurat e përfituara nga punëdhënësi, shoqëria “{\*\*\*}”. [...] Ndërsa, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues ka konstatuar të njëjtin kujdes të treguar nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me deklarimin e bërë mbi marrëdhënien e punësimit, në deklaratat periodike dhe deklaratën “vetting”, ku bazuar në kontratën e punës, ka deklaruar të ardhurat e përfituara në shumën 50.000 lekë/muaj. Nisur nga fakti se pagat nga ky punëdhënës janë dhënë nëpërmjet bankës, trupi gjykues vlerëson se bashkëshorti i subjektit ka qenë në dijeni të shumës së marrë dhe në një logjikë të thjeshtë edhe të kontributit të paguar dhe që për pasojë kjo bën që përlllogaritjet të përfshijnë në mënyrë të përpiktë, për qëllim të këtij vlerësimi, të ardhurat për aq sa janë paguar kontributet përkatëse. [...] c. Në lidhje me impaktin që sjellin të ardhurat e ligjëruara në analizën financiare për vitin 2011 (kohë në të cilën është bërë kjo pasuri), gjendja “cash” në shumën 1.000.000 lekë, e krijuar dhe e deklaruar në vitin 2010, [...] nisur nga fakti që u provua ligjshmëria e të ardhurave të bashkëshortit të subjektit, të siguruara për vitet 2008-2012, nga punësimi në shoqërinë “{\*\*\*}”, provohet edhe mundësia e krijimit të gjendjes “cash” një vit më parë. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen me vend logjikën e përdorur nga subjekti se për sa kohë është provuar se shuma 1.000.000 lekë ka qenë e mundur të kursehet nga bashkëshortët, kjo shumë lehtësisht mund të jetë investuar në blerjen e kësaj pasurie, duke qenë se në çdo rrethanë bie në sy fakti që si burim krijimi janë përdorur vetëm të ardhura të realizuara nga pagat e bashkëshortëve dhe në këtë drejtim blerja e pasurisë në muajin prill 2011, pranon përfshirjen e kursimeve të fillim vitit dhe të atyre të mbartura nga një vit më parë. Nën këtë analizë logjiko-juridike, por edhe matematikore, trupi gjykues çmon se subjekti ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie. Në vijim të provueshmërisë së burimit të ligjshëm të kësaj pasurie, për sa i përket pretendimit të subjektit për të përfshirë në analizën financiare të vitit 2011 deri në kohën e blerjes së kësaj pasurie, të ardhurat shtesë krahas pagës fikse, të përfituara nga bashkëshorti i subjektit në shoqërinë “{\*\*\*}”, trupi gjykues mban në konsideratë disa faktorë të cilët mbështesin pretendimin e subjektit. [...] Trupi gjykues çmon se qëndron pretendimi i subjektit lidhur me përfshirjen në analizën financiare të vlerës prej 400.000 lekësh, përshkruar dhe përfituar sipas pasqyrës së llogarisë personale lëshuar në datën

---

<sup>17</sup> Shih paragrafin 2.16 të vendimit nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit.

10.01.2011. [...] Si rezultat, analiza financiare deri në datën 11.04.2011, duke përfshirë të ardhurat nga paga nga dy punëdhënësit, shuma shtesë prej 400.000 lekësh, si dhe gjendja “cash” në shumën 1.000.000 lekë, rezulton në balancë pozitive për krijimin e kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera.

Për pasurinë automjet tip “Audi A2”<sup>18</sup>: Trupi gjykues vlerëson të mos përsëritet në vlerësimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramit të kësaj pasurie dhe burimit të ligjshëm të krijimit të saj, pasi ka arsyetuar gjerësisht në provueshmërinë e të ardhurave të siguruara nga puna e bashkëshortit të subjektit në pasurinë e parë, burime për të cilat u provua plotësisht ligjshmëria e tyre dhe që impaktojnë po ashtu edhe në blerjen e kësaj pasurie të luajtshme. [...] Në kushte të tilla, trupi gjykues çmon se subjekti ka kryer deklaramit të mjaftueshëm lidhur me këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj, ka pasur mundësi financiare, si dhe ka provuar burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit.

- 45 Komisioneri Publik, në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi arsyetimin dhe konkluzionet e Komisionit lidhur me këto dy pasuri, me pretendimin se nuk janë të bazuara në prova, në ligjin e zbatueshëm, si dhe jurisprudencën e Kolegjit. Komisioneri Publik ka ndarë qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, për sa i përket mbulimit me burime të ligjshme të shumës së paguar nga subjekti i rivlerësimit nga kursimet në *cash* deri në vitin 2011. Këtë shkak të ankimit të tij, Komisioneri Publik e mbështet në pretendimet dhe argumentet e mëposhtme.

45.1 Mbetet i pabazuar pretendimi i subjektit mbi përdorimin e kursimeve në *cash* të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2010, si burim për krijimin e pasurive dhe në mbulimin e shpenzimeve deri në datën 16.04.2011, për sa kohë që ky deklaramit nuk është bërë në deklaratën periodike të vitit 2011. Deklaramit e subjektit gjatë hetimit administrativ mbi posedimin dhe ndryshimin e likuiditeve në *cash*, deri në vitin 2011, nuk përputhen me deklaramit e vetë subjektit në deklaratat periodike vjetore, të cilat, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe në praktikën e Kolegjit, konsiderohen si provë.

45.2 Nga analiza financiare, lidhur me këto pasuri, në të cilën janë përfshirë të ardhurat për periudhën janar 2011 - 16.04.2011, të subjektit të rivlerësimit dhe të ardhurat e bashkëshortit, si dhe të ardhurat e pretenduara të arkëtuara në formën e paradhënies dhe shpërblimit nga “{\*\*\*}”, person fizik; shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare për të njëjtën periudhë, shpenzimet për blerjen e pasurive dhe ndryshimet në likuiditetet në llogaritë bankare, Komisioneri Publik i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe, rrjedhimisht, nuk mbulon me të ardhura të ligjshme blerjen e këtyre pasurive për një diferencë negative, prej 849.435 lekësh.

- 46 Lidhur me këtë shkak të ankimit, në parashtrimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit argumentoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të pasurisë objekt kontrolli, janë të pabazuara, e për pasojë kërkoi që Kolegji të mos marrë në konsideratë këtë shkak

---

<sup>18</sup> Shih paragrafin 7.6 të vendimit nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit.

ankimi. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendoi, në mënyrë të përmbledhur, si vijon.

**46.1** Në deklaratën vjetore periodike të vitit 2010, ka deklaruar kursime në *cash* në shumën 1.000.000 lekë. Shuma e kursyer prej 1.000.000 lekësh vjen nga të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), dhe e bashkëshortit të saj në vitin 2010, të ardhura këto të ligjshme, referuar dhe analizës financiare për këtë vit, pranuar si nga Komisioni, ashtu dhe nga Komisionieri Publik, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në deklaratën e rivlerësimit ka deklaruar, ndër burimet e krijimit që shërbyen për blerjen e apartamentit në {\*\*\*}, edhe “kursime nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortit tim”.

**46.2** Në vitin 2010, ka deklaruar për herë të parë kursime gjendje *cash* në fund të vitit. Deri para kësaj periudhe, ajo dhe bashkëshorti kishin investuar të gjitha kursimet për blerjen e apartamentit në Tiranë. Gjendja e likuiditeteve në *cash* në fund të vitit 2010 ka qenë 1.000.000 lekë dhe kjo shtesë likuiditeti kishte si burim krijimi kursimet nga pagat gjatë vitit 2010. Në datën e krijimit të pasurisë, që është 11.04.2011, gjendja e pasurisë në likuiditet kishte vetëm kursimet nga paga. Shtimi i gjendjes së *cash*-it në fund të vitit 2010, kishte si burim kursimet nga paga. Përdorimi i kursimeve nga paga në datën e krijimit të pasurisë është në fakt pakësimi i kësaj gjendjeje kursimesh në *cash* të krijuar një vit më parë. Burimi “kursime nga pagat” ka të njëjtin kuptim si “pakësim të kursimeve nga pagat”. Në deklaratën e rivlerësimit u është referuar jo vetëm kursimeve për periudhën e vitit 2011 deri në momentin e blerjes së pasurive, por edhe kursimeve nga paga nga viti 2010.

**46.3** Mosdeklarimi i burimit të krijimit dhe pakësimit të gjendjes në *cash* në deklaratën periodike të vitit 2011, për blerjen e apartamentit në {\*\*\*}, Kavajë, më datë 11.04.2011, duhet konsideruar si pasaktësi, në vijim të qëndrimit të konsoliduar tashmë të Kolegjit, se pasaktësitë në deklaratimet periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

**47** Në shqyrtimin e shkakut të ankimit lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurive “apartament banimi në {\*\*\*}, Kavajë” dhe “automjet, tip “Audi A2””, nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të paraqitura prej tij, gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues konstatoi si vijon.

**47.1** Pasuria “apartament banimi në {\*\*\*}, Kavajë”, me sipërfaqe totale 45,6 m<sup>2</sup>, është blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me anë të kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.04.2011, të lidhur mes tij dhe z. A. N., në cilësinë e palës shitëse. Vlera e apartamentit është 1.837.305 lekë, shumë e cila është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë ka konfirmuar<sup>19</sup> se pasuria në fjalë është regjistruar në emër të z. K. O., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, më datë 19.04.2011.

---

<sup>19</sup> Në informacionin e përcjellë në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.06.2019.



Pasuria “automjet, tip “Audi A2””, është blerë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), me anë të kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.04.2011, të lidhur mes saj dhe z. A. S. në cilësinë e palës shitëse, në vlerën 3.000 euro, shumë e cila është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, në informacionin e përcjellë në Komision<sup>20</sup>, ka konfirmuar se automjeti në fjalë është regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

**47.2** Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar lidhur me këto dy pasuri:

*1. Apartament banimi, {\*\*\*}-Kavajë, me sipërfaqe 45,6 m<sup>2</sup>. Blerë me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.04.2011, nga shtetasi A. N.. Burimi i krijimit: Kursime nga të ardhurat nga pagat. Vlera: 1.837.305 lekë. Pjesa takuese: 50 %. [...]*

*6. Automjet tip “Audi A2”, viti i prodhimit 2001, me targa {\*\*\*}, blerë nga shtetasi A. S., me kontratën e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.04.2011. Vlera: 3.000 euro. Burimi i krijimit: Të ardhura nga puna. Pjesa takuese: 100 %.*

**47.3** Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*Shtuar, blerë apartament në {\*\*\*}-Kavajë, me sipërfaqe 45,6 m<sup>2</sup>, sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.04.2011. (Të ardhurat dhe kursimet). Vlera: 1.837.305 lekë. Pjesa takuese: 1/2.*

*Shtuar, blerë automjet i tipit “Audi A2”, me targa {\*\*\*}, me kontratën me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.04.2011, ku blerëse jam unë, Enkeleda Osmani. Vlera: 3.000 euro. (Të ardhurat dhe kursimet). Pjesa takuese: 1/2.*

**47.4** Në deklaratën periodike të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kursyer shuma prej 1.000.000 lekësh nga të ardhurat nga pagat.*

**47.5** Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës<sup>21</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, kam deklaruar kursime “cash” në shumën 1.000.000 lekë dhe ashtu si kam deklaruar në deklaratën e rivlerësimit, kjo shumë u pakësua për blerjen e apartamentit në {\*\*\*}. Në fund të vitit 2011, nga paga ime dhe të ardhurat e bashkëshortit tim, kam kursyer shumën 800.000 lekë. Në deklaratën individuale vjetore të vitit 2011, është e vërtetë që nuk kam deklaruar pakësim të gjendjes “cash”, në shumën 200.000 lekë, por ndodhur në këto rrethana, çmoj se situata faktike, ndonëse nuk është deklaruar saktë, duhet lexuar e kuptuar në linjën logjike që kam paraqitur në përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 4, për sa kohë që, pavarësisht paqartësisë në deklaram, unë nuk kam pasur mundësi të kurseja më shumë se 800.000 lekë pas investimeve në blerjen e pasurisë apartament, ndodhur në {\*\*\*} dhe automjetit tip “Audi A2” [...].*

<sup>20</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.05.2019.

<sup>21</sup> Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, barrën e provës: “Në lidhje me gjendjen “cash”, duket se ka mospërputhje midis vlerave të gjendjes “cash” të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe deklaramet e bëra në pyetësorin nr. 2, datë 02.10.2019 dhe pyetësorin nr. 4, datë 16.10.2019”.

- 48 Në vijim të sa më sipër, në analizë të pretendimit të Komisionerit Publik, në raport me të gjitha rrethanat që kanë rezultuar gjatë hetimit administrativ, si dhe duke konsideruar edhe shpjegimet e deklaramentit të rivlerësimit në Komision, të cilat janë një prej mjeteve të kërkimit të provës për efekt të këtij procesi<sup>22</sup>, ashtu siç do të shtjellohen në vijim, si dhe shpjegimet e subjektit të dhëna gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues vëren se burimet e krijimit, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, për krijimin e dy pasurive të sipërcituara, e të kontrolluara edhe nga Komisioni, për periudhën janar 2011 - 16.04.2011, janë:
- (i) të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit, në shumën 285.606 lekë<sup>23</sup>;
  - (ii) të ardhurat e bashkëshortit, nga punësimi pranë “{\*\*\*}” Person Fizik E. M.<sup>24</sup>, në shumën 495.000 lekë dhe të ardhurat e arkëtuara në formën e paradhënies dhe shpërbimit në shumën 800.000 lekë nga i njëjti punëdhënës;
  - (iii) të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në shumën 113.472 lekë<sup>25</sup>;
  - (iv) kursimet në *cash* nga viti 2010, në shumën 1.000.000 lekë, dhe të ardhurat e vitit 2011.
- 49 Në shqyrtim të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, në raport me shkakun e ankimit, trupi gjykues vëren se vlerësimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur janë në pamundësi financiare për të mbuluar me burime të ligjshme blerjen e apartamentit të banimit në {\*\*\*}, Kavajë dhe automjetit tip “Audi A2”, për një diferencë negative prej 849.435 lekësh, është afektuar tërësisht nga moskonsiderimi prej tij si burim krijimi për dy pasuritë objekt kontrolli, i shumës prej 1.000.000 lekësh kursime në *cash*, me pretendimin se subjekti rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësimin e tyre në deklaratën periodike të vitit 2011, i cili ishte dhe pretendimi thelbësor lidhur me këto dy pasuri. Në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003, sipas parashikimeve të nenit 4 të tij, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo ndryshim të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht, si dhe burimin e krijimit

<sup>22</sup> Neni 49 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë: [...] b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku [...]”.

<sup>23</sup> Siç ka rezultuar nga të dhënat e vërtetimit të Prokurorisë Durrës, datë 18.01.2017.

<sup>24</sup> Të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas të dhënave të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 12.11.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), në të cilën konfirmohen pagesat e kryera për tatimin në burim nga personi fizik E. M., në favor të z. K. O., si në vijim. Për vitin 2008, paguar tatimi në burim në shumën 22.200 lekë, për principalin 222.000 lekë, me përshkrimin: “Likuiditet për tatim në burim, kontratë të lidhur nga P/fizik E. M., në favor të K. O.”. Me të njëjtin përshkrim, për vitin 2009, është paguar tatim në burim në shumën 126.035 lekë për principalin 1.260.350 lekë; për vitin 2010, është paguar tatim në burim në shumën 123.339 lekë, për principalin 1.233.390 lekë; për vitin 2011, është paguar tatim në burim në shumën 165.090 lekë, për principalin 1.650.090 lekë; për vitin 2012, është paguar tatim në burim në shumën 132.943 lekë, për principalin 1.329.430 lekë; si dhe të dhënave të “Pasqyrës së llogarisë personale, datë 13.04.2011”, e nënshkruar ndërmjet shtetasve E. M. dhe K. O., sipas së cilës z. O., në këtë datë, ka përfutur paradhënie të ardhurash, në shumën 500.000 lekë.

<sup>25</sup> Nga informacioni i përcjellë në Komision nga ISSh-ja, Drejtoria Rajonale Shkodër, vërtetohet se në mbështetje të formularëve “Listëpagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi {\*\*\*}”, në emrin e z. K. O. është paguar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, shuma 93.774 lekë, për periudhën janar - korrik 2011, ndërsa sipas “Vërtetimit mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare” vërtetohet se i siguruari, z. K. O., për periudhën 01.12.2010 - 31.07.2011, ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi, në shumën 48.000 lekë në muaj, pagë bruto në total 336.000 lekë bruto.

të saj. Në analizë të deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), megjithëse nuk ka deklaruar sipas detyrimit ligjor pakësimin e kursimeve në *cash*, ajo ka deklaruar se burimi i krijimit të pasurisë “apartament banimi në {\*\*\*}, Kavajë” dhe “automjet, tip *Audi A2*” janë të ardhurat dhe kursimet. Në interpretim të burimit të krijimit të pasurive, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit [burim krijimi i cili është konfirmuar nga subjekti i rivlerësimit edhe në deklaramet mbi burimet e krijimit për këto pasuri në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit], trupi gjykues vlerësoi se ndonëse shuma e akumuluar e kursimeve në *cash* nuk është deklaruar e pakësuar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të pasurisë së vitit 2011, rezulton të jetë identifikuar në të njëjtin deklaram si burim krijimi për pasuritë objekt kontrolli. Edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, është saktësuar se kursimet në *cash* të krijuara nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj janë përdorur si burim krijimi për pasurinë apartament banimi, në {\*\*\*}. Nga transaksionet e kryera për krijimin e pasurive objekt kontrolli në fillim të tremujorit të dytë të vitit kalendarik e në distancë kohore shumë të shkurtër, prej 7 ditësh, nga njëra-tjetra, deduktohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur arsye për të përdorur kursimet në *cash* si burim për krijimin e tyre. Në këtë kuptim, mosdeklarami i pakësimit të kursimeve në *cash* në shumën 1.000.000 lekë në fund të vitit 2011, konsiderohet nga trupi gjykues një pasaktësi në deklaram, që nuk përfaqëson realisht ecurinë e situatës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur për këtë vit. Në këtë arsyetim, trupi gjykues u mbështet edhe në rezultatin e analizës financiare të kryer në Kolegj, i cili tregoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi që të krijonte kursimet në *cash* të deklaruara në fund të vitit pararendës 2010, e për rrjedhojë t’i përdorte ato për krijimin e pasurive objekt kontrolli. Në konkluzion, në vlerësimin e trupit gjykues, kjo shumë duhet të përfshihet në të ardhurat e përdorura për blerjen e pasurive në vitin 2011.

- 50 Duke konsideruar konkluzionin e mësipërm, sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, duke renditur shumën prej 1.000.000 lekësh në burimet e përdorura për krijimin e pasurive objekt kontrolli, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kishin mundësi të justifikonin me burime të ligjshme blerjen e pasurisë “apartament banimi në {\*\*\*}” dhe “autoveturë *Audi A2*”, deri më datë 16.04.2011, në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
- 51 Në lidhje me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e vitit 2012, për një diferencë negative prej 376.692 lekësh dhe në vitin 2015, për një diferencë negative prej 262.928 lekësh, trupi gjykues konstatoi si vijon.
- 52 Komisioni, në vendim<sup>26</sup>, për sa i përket analizës financiare për vitin 2012, ka arsyetuar se: [...] Nga analiza financiare, dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 479.610 lekë, për të shlyer një pjesë të huas dhe për të përballuar shpenzimet e tjera të vitit dhe, mbi këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës. Subjekti, në parashtrimet e saj, ashtu sikurse ka pasqyruar qëndrimin në të gjitha pasuritë e mësipërme, edhe në këtë rast, ka shpjeguar mbi provueshmërinë e burimit të ligjshëm të të ardhurave të përfituara nga punësimi i bashkëshortit të saj. Trupi gjykues, në analizë të fakteve të konstatuara dhe parashtrimeve të subjektit, arsyeton si

<sup>26</sup> Shih paragrafin 9.3 të vendimit nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit.

vijon: Nisur nga fakti që subjekti ka deklaruar si burim për shlyerjen e huas të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit, si dhe pakësimin e gjendjes “cash” të siguruar nga një vit më parë, analiza përqendrohet në provueshmërinë e burimit të ligjshëm të të ardhurave të siguruara nga punësimi i bashkëshortit dhe në pakësimin e gjendjes “cash” të pretenduar. Duke qenë se bashkëshorti i subjektit rezulton që në këtë vit kalendarik të ketë qenë i punësuar pranë dy shoqërive dhe, konkretisht, në “{\*\*\*}” me të ardhura vjetore në shumën prej 1.200.000 lekësh dhe në “American Rebuilder” ShPK, me të ardhura vjetore në shumën 576.000 lekë, trupi gjykues çmon të mos ripërsëritet në vlerësimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, për sa kohë ka detajuar në pasuritë e mësipërme, ku janë përdorur pikërisht këto burime financiare. Ndërsa, në lidhje me pretendimin e përfshirjes në analizë financiare të pakësimit të gjendjes “cash” nga viti i mëparshëm, trupi gjykues ka konkluduar për këtë çështje, më sipër, në këtë vendimmarrje dhe, për pasojë, nuk merr në konsideratë si burim krijimi gjendjen “cash” të pretenduar. Megjithatë, nga analiza financiare, subjekti rezulton në balancë pozitive. Në kushte të tilla, trupi gjykues çmon se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të shlyer huan në shumën 5.000 euro dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare përgjatë vitit 2012.

- 53 Lidhur me investimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, përgjatë viteve 2004 - 2016, Komisioni, në vendim, ka arritur në përfundimin se: Subjekti, në tërësi, ka pasur mundësi financiare për të mbuluar investimet e kryera në pasuri të paluajtshme apo të luajtshme përgjatë viteve 2004 - 2016, si dhe ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Balanca negative e shpërndarë në katër vjet, përkatësisht: në vitin 2008, në shumën 143.348 lekë; në vitin 2011, në shumën 280.151 lekë; në vitin 2013, në shumën 19.153 lekë; si dhe në vitin 2015, në shumën 316.903 lekë, për të cilën/at, trupi gjykues, duke mbajtur në vëmendje dhe aplikuar parimin e proporcionalitetit, çmon se ato nuk janë të mjaftueshme për të aplikuar ndonjë masë, sipas nenit 61 (3) të ligjit nr. 84/2016.
- 54 Lidhur me sa më sipër, Komisioneri Publik, në ankim, ka pretenduar se në vlerësim të akteve të administruara në dosjen e Komisionit dhe pas analizës financiare të kryer mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për periudhën e deklarimit, konstaton se, përveç problematikave të mësipërme, subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e vitit 2012 (vit kur deklarohet shlyerja pjesore e huas së marrë për apartamentin në {\*\*\*}, Tiranë), për një diferencë negative prej 376.692 lekësh; dhe në vitin 2015, për një diferencë negative prej 262.928 lekësh, në total për një diferencë negative prej 639.890 lekësh. Në konkluzionet përfundimtare, Komisioneri Publik parashtroi si vijon.  
Për sa u përket shkaqeve të ankimit mbi konstatimin e diferencave negative edhe për vitet 2012 dhe 2015, Komisioneri Publik, pasi analizoi prapësimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, vlerëson se, bazuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. {\*\*\*}, datë 05.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe atë nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në konsideratë të përfshirjes së të ardhurave nga pagat e bashkëshortit të subjektit sipas dy vendimeve respektive, përmbysat diferencën negative e vitit 2012 dhe ngelet në fuqi diferencën negative e konstatuar për vitin 2015, për një diferencë negative në shumën 262.968 lekë, pasi, sikundër trajtuar dhe më sipër, në rastin e pasurisë nr. 2, pretendimet e subjektit mbi mosdeklarim të saktë të kursimeve në “cash” (konkretisht, pakësimit dhe përdorimit të tyre) mbeten në nivel deklarativ, referuar me jurisprudencën e Kolegjit për raste të ngjashme. Komisioneri Publik, në përfundim të hetimit gjyqësor e pasi analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka vlerësuar se pretendimet e paraqitura prej tij në ankim lidhur me analizën

financiare për vitin 2012, morën zgjidhje nga hetimi gjyqësor dhe u konsideruan se nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimit të Komisionit. Në kushtet kur edhe nga analiza financiare e kryer në Kolegj, u gjet i drejtë qëndrimi i sipërcituar i Komisionerit Publik, trupi gjykues çmoi se pretendimet e tij në ankim nuk duhet të jenë pjesë e vlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për sa kohë që kërkimi i Komisionerit Publik për ndryshimin e vendimit nuk u mbështet në to, por në shkaqet e tjera të ankimit.

- 55 Në vijim, lidhur me diferencën negative në shumën 262.968 lekë për vitin 2015, e cila mbeti në vlerësimin e Komisionerit Publik si arsye mbi të cilën i kërkohet Kolegjit ndryshimi i vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo), në parashtrimet para Kolegjit, argumentoi se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me analizën financiare të vitit 2015, janë të pabazuara, pasi:

55.1 Gjatë gjithë deklaramëve të kryera prej saj në periudhën 2003-2016, ka deklaruar dy herë shtim/gjendje të kursimeve në *cash*, në vitin 2010 dhe vitin 2012 dhe asnjëherë pakësim të tij në fund të vitit. Kjo për faktin se duke deklaruar shpenzimet e kryera dhe shtimin e ndonjë pasurie të luajtshme, ka deklaruar nga ana tjetër edhe pakësimin e gjendjes së kursimeve në *cash*, bazuar në parimin e regjistrimit të dyfishtë, që flukset dalëse monetare përballohen nga pakësimi i pasurisë monetare.

55.2 Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet për pushimet verore në shumën 2.750 euro, por nga ana tjetër nuk ka deklaruar saktësisht pakësimin e kursimeve në *cash*. Kjo për arsye se në deklaratën periodike vjetore, në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme” kërkohet të përshkruhet çdo shpenzim i deklarueshëm me vlerë mbi 300.000 lekë dhe jo burimi financiar për përballimin e këtij shpenzimi të deklarueshëm. Shpenzimet e sipërcituara janë përballuar tërësisht nga gjendja e likuiditeteve në *cash*, duke zëruar gjendjen e tyre. Pasaktësia në deklaratën periodike të interesave të vitit 2015 nuk është mundur të korrigjohet as në dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit, pasi nuk ka pasur rubrikë për deklarimin e shpenzimeve të deklarueshme gjatë periudhës së rivlerësimit dhe burimit të përdorur për përballimin e tyre.

- 56 Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi, fillimisht, se në deklaratën periodike të interesave të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën “Shpenzimet e deklarueshme”, ka deklaruar: *Pushime nga data 01.08.2015 deri në datën 10.08.2015 në {\*\*\*}, Turqi (me shoqërinë {\*\*\*}). Vlera 2.750 euro.*

Nga verifikimi i mëtejshëm i kësaj deklarate, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në të shtesa apo pakësime të kursimeve në *cash*.

Trupi gjykues sjell në vëmendje se deklarata periodike e interesave e vitit 2015, është i vetmi dokument nga i cili merren të dhëna lidhur me ndryshimet e gjendjes së kursimeve në *cash* të subjektit të rivlerësimit. Faktin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit se formulari i deklarimit periodik, për sa u përket shpenzimeve të deklarueshme, nuk kërkon burimin financiar të përballimit të tyre, trupi gjykues e konsideroi të pabazuar, pasi në këtë formular, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, kërkohet të pasqyrohet vlera në lekë apo valutë, e shtuar apo e pakësuar e likuiditeteve, gjendje në *cash*, gjë e cila, sikurse rezultoi, nuk ishte plotësuar nga ana e subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, referuar edhe një qëndrimi të konsoliduar tashmë, të mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit, si dhe në kushtet kur pretendimi se shpenzimet e pushimeve ishin përballuar nga kursimet e akumuluar në *cash* nuk gjen gjurmë pasqyrimi në deklaratën periodike, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbeti në nivel deklarativ. Në këto rrethana, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk justifikon

me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e vitit 2015, në shumën 241.928 lekë, për pasojë gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 57 Trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme që lidhet me kryerjen e pagesave të kësteve për pasurinë apartament banimi ndodhur në {\*\*\*}, Tiranë dhe shpenzimet e investimeve kryera në vitet 2006, 2008 dhe 2015, e cila rezultoi në shumën 981.732 lekë, nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk është e mjaftueshme për të cenuar nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit në kuptim të përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
- 58 Bazuar në përfundimet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se vendimi nr. 275, datë 20.07.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 275, datë 20.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 16.02.2023.

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*